

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Participim: 18.08.2020

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me Nr.03/L-040, si dhe Thirrjes për Aplikim të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datë 29.05.2020,

MARRËVESHJE ME PARTICIPIM
(Për projektin “Ngritja e Serrave në sipërfaqe prej 50m²”)

E përpiluar në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Xhafer Tahiri në njërin anë në cilësinë e subvencionuesit, dhe

2. Grupit të përfituesve të Serrave që kanë participuar për projektin “Ngritja e Serrave në sipërfaqe prej 50m²” të cilin e përfaqësojnë me autorizim:

- Kujtim Zeqiri nga fshati Novolan me Nr. Personal: 1175737894;
- Bajram Maliqi nga fshati Dobërlukë me Nr. personal: 1240326821;
- Hajrije Oshlani nga Vushtrria me Nr. personal: 1007076742;

Neni 1
Qëllimi

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në sektorin e perimtarisë.

Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfituesve (të serrave në sipërfaqe prej 50m²) të Komunës, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesve për realizimin e projektit “Ngritja e Serrave në sipërfaqe prej 50m²” në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë dhe IRW si subvencionues kryesor i projektit.

Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesve të serrave për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **800.00 €**

Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **2800.00 €**, ndërsa që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **3600.00€**

Neni 5

Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

Neni 7

Obligimet e përfituesit

7.1 Përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej **200.00 € për projektin “Ngritja e Serrave në sipërfaqe prej 50m²”** në njërën llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.

7.2. Dy serrat të cilat janë të dedikuara për shoqatën “HENDIKOS” janë të liruara nga participimi.

7.3 Serra brenda afatit prej tri (3) viteve nga dita e nënshkrimit të kontratës është aset i Komunës së Vushtrrisë, dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet shitet, dhurohet ose të epet me qira, në të kundërtën do të merren masa ligjore.

Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.


Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S

Investitori:

Komuna e Vushtrrisë

 Z. Xhafer Tahiri

(Kryetar i Komunës)



Përfaqësuesit e përfitueseve të Serrave në sipërfaqe prej 50m² :

1. Kujtim Zeqiri 

2. Bajram Maliqi 

3. Hajrije Oshlani 